



**PHD CAND. VERA
HOXHA**

Asistent Lektor

Departamenti i Shkencave
të Aplikuara dhe Kompjuterike

KONTAKTE

✉ v.hoxha@umb.edu.al



**PHD CAND. VERA
HOXHA**

Asistent Lektor

Departamenti i Shkencave
të Aplikuara dhe Kompjuterike

BIOGRAFIA

PhD Cand. Vera Hoxha ka përfunduar studimet universitare në nivel Bachelor (2018-2021) dhe Master i Shkencave (2021-2023) në degën “Matematikë”, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri. Në shkurt 2025, ajo është regjistruar në programin e Doktoratës në Matematikë Teorike, me temë kërkimore që fokusohet në Teorinë e Oshilacionit të Ekuacioneve Diferenciale Jolineare, duke përdorur kushte jolineariteti të dhënë me anë të integraleve.

Aktiviteti i saj mësimor dhe shkencor përqendrohet kryesisht në disiplina si Ekuacionet Diferenciale, Analiza Reale dhe Komplekse, si dhe Algjebra dhe Gjeometria, me një fokus të veçantë në: Oshilacionin dhe Jooshilacionin e Zgjidhjeve të Ekuacioneve Diferenciale Jolineare, Sistemet Dinamike, Analizën Komplekse dhe Gjeometrinë Analitike.

Aktualisht, Vera është e angazhuar si pedagoge pranë Universitetit Barleti, ku zhvillon lëndët në fushën e matematikës. Ajo ka një përvojë akademike në universitete të ndryshme si: Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti Polis, ku jep lëndë si: Analizë Matematike I & II, Matematikë e Zbatuar (moduli “Ekuacione Diferenciale”), Gjeometri, Matematikë e Përgjithshme I & II, Algjebër dhe Gjeometri, Teoria e Funkcionit të Variablit Kompleks, etj.

Ndër arritjet e saj më të rëndësishme përmenden publikimi i artikujve shkencorë dhe pjesëmarrja në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e Ekuacioneve Diferenciale, Teorisë së Masës dhe Integritit, si dhe në Edukimin e Matematikës.

Vera është e angazhuar në realizimin e konkurseve ndërkombëtare të matematikës, si Math Kangaroo, ku kontribuon në përgatitjen dhe përzgjedhjen e pyetjeve, si dhe në organizimin e aktivitetit në tërësi. Prej vitesh ajo është një nga koordinatorët e Olimpiadës së Përbashkët Kosovë-Shqipëri në Matematikë (KAMO).